



Republika e Kosovës
Kryeministri

Tiranë, më 13 shkurt 2025

Shkëlqesia Juaj,

I dashur Albin,

Përvjetori i 17-të i shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më ofron rastin e duhur t'Ju përcjell urimet e mia më të përzemërta në këtë ditë historike për kombin tonë. Përtej sfidave të shumta e sakrificave të mëdha, me mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakursyer të aleatëve tanë të pazëvendësueshëm, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian, Republika e Kosovës ka shënuar arritje të paimagjinueshme në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe Shtetit të së Drejtës. Një histori progresi të gjithanshëm demokratik dhe prosperiteti.

Përulemi sot përpara themeluesve të Republikës, duke shprehur pafundësisht mirënjohjen tonë. Një rrugëtim sfidues dhe i suksesshëm deri më 17 shkurt të vitit 2008, ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe një rrugëtim po kaq sfidues e i suksesshëm, deri më sot, për forcimin e saj.

Edhe një herë, duke riafirmuar gjithë vullnetin tonë për bashkëpunim të gjithanshëm, unë, Ju uroj nga zemra gëzuar Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Shkëlqesia Juaj, dhe nëpërmjet Jush, gëzuar të gjithë motrave e vëllezërve të Kosovës!

Vëllazërisht,

Edi Rama

Sh.T.Z. Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës
Prishtinë